



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija
Ministry of Education Science and Technology

MATURA SHTETËRORE 2018

Prishtinë , 2018



UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËPËRGJIGJES:

Të gjitha shënimet e kërkuara duhet të barten në Fletëpërgjigje, si p.sh.

Në rubrikën KODI I IDENTIFIKIMIT duhet shënuar kodin e komunës, kodin e shkollës e kështu me radhë.

MËNYRA E PLOTËSIMIT TË FLETËPËRGJIGJES:

KODI I IDENTIFIKIMIT																			
Komuna					Shkolla					Paralela					Nr. i ditarit				
0	1	2	3	4	0	1	2	3	4	0	1	2	3	4	0	1	2	3	4
●	0	0	0	0	●	0	0	0	0	●	0	0	0	0	●	0	0	0	0
1	1	1	1	1	●	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	●	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	●	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3
4	●	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9	9

Në Broshurën e testit janë kërkesat (pyetjet) me nga katër alternativa, prej të cilave vetëm njëra është e saktë. Përgjigjen që mendoni se është e saktë duhet rrethuar në test dhe të njëjtën duhet bartur në fletëpërgjigje.

Shembull: Kërkesa e testit

Është dhënë vargu i numrave: 1, 3, 7, 15, 31,... Cili është numri vijues në vargun e dhënë?

A. 67

B. 65

C. 63

D. 61

Alternativa C është e saktë. E rrethoni atë në test dhe të njëjtën e ngjyrosni me laps grafit në Fletëpërgjigje, në këtë mënyrë: 14 A B ● D

Përndryshe, do të konsiderohet gabim nëse plotësohet në formë tjetër, si p.sh.: 14 ● B ● D apo 14 A B C D

Duhet pasur kujdes që, përgjigjen e saktë të një kërkesë të mos e vendosim mbi kërkesën tjetër.

Duhet pasur kujdes që hijezimi i shënimeve të jetë i plotë.

Plotësoni me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha të dhënat.

Lexoni me kujdes kërkesat –pyetjet e pastaj shënoni vetëm njërën nga katër përgjigjet që konsideroni se është e saktë.

Çdo pyetje e saktë vlerësohet me një pikë, ndërsa çdo pyetje e pasaktë vlerësohet me zero pikë.

Pyetja e paplotësuar, gjithashtu vlerësohet me zero pikë (0).

Fletëpërgjigjja plotësohet vetëm me laps grafit.

Kini kujdes gjatë mbushjes dhe bartjes së përgjigjeve nga broshura e testit në Fletëpërgjigje, sepse vetëm Fletëpërgjigjet lexohen, krahasuar me Broshurën e testit.

Përgjigjen e saktë e plotësoni në Broshurën e testit dhe, njëkohësisht e bartni në Fletëpërgjigje.

P.sh: Nëse në test, për pyetjen numër 1 keni konsideruar se alternativa C është e saktë, atëherë edhe në Fletëpërgjigje e plotësoni alternativën C.

Po ashtu, nëse për pyetjen numër 2 konsideroni se përgjigja e saktë është alternativa B, edhe në Fletëpërgjigje e plotësoni alternativën B. Shih figurën:

Pikë negative nuk ka.

1	A	B	●	D
2	A	●	C	D

Llogaritjet apo ndonjë shënim tjetër mund t'i bëni në Broshurë të testit e assesi në Fletëpërgjigje.

Lapsat me ngjyrë nuk lexohen nga "Lexuesi Optik"

DATA ME RËNDËSI

Afati i Qershorit:

- Mësimi për maturantë përfundon më **11 maj 2018**
- Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore bëhet më **14- 24 maj 2018**

Provimi i Maturës Shtetërore

Dita e parë, më:

- **28 maj 2018 Regjioni i Ferizajit** (Ferizaj, Lipjan, Shtime, Kaçanik, H. i Elezit, Shtërpçë) dhe **Regjioni i Gjilanit** (Gjilan, Kamenicë, Viti, Artanë);
- **29 maj 2018 Regjioni i Prishtinës** (Prishtinë, Podujevë, Obiliq, F. Kosovë, Drenas);
- **30 maj 2018 Regjioni i Gjakovës** (Gjakovë, Rahovec, Malishevë) dhe **Prizrenit** (Prizren, Therandë, Dragash, Mamushë);
- **31 maj 2018 Regjioni i Pejës** (Pejë, Deçan, Klinë, Istog, Junik) dhe **Regjioni i Mitrovicës** (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj);

Dita e dytë, më:

- **5 qershor 2018 Regjioni i Ferizajit** (Ferizaj, Lipjan, Shtime, Kaçanik, H. i Elezit, Shtërpçë) dhe **Regjioni i Gjilanit** (Gjilan, Kamenicë, Viti, Artanë);
- **6 qershor 2018 Regjioni i Prishtinës** (Prishtinë, Podujevë, Obiliq, F. Kosovë, Drenas);
- **7 qershor 2018 Regjioni i Gjakovës** (Gjakovë, Rahovec, Malishevë) dhe **Regjioni i Prizrenit** (Prizren, Therandë, Dragash, Mamushë);
- **8 qershor 2018 Regjioni i Pejës** (Pejë, Deçan, Klinë, Istog, Junik) dhe **Regjioni i Mitrovicës** (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj);

Publikimi i rezultateve: 18 qershor 2018

- Ankesat e nxënësve: 19 - 21 qershor 2018
- Rezultati i ankesave: 23 qershor 2018

Paraqitja e provimit të maturës bëhet në drejtorinë e shkollës dhe evidentohet në fletore të posaçme, me numër protokolli, me dokumente të nevojshme.

Kandidatët që nuk e paraqesin me kohë Provimin e Maturës Shtetërore, konsiderohet se kanë **hequr dorë nga provimi**.

ÇFARË NË DITËN E PROVIMIT ?

Maturantëve u lejohet të:

- Jenë të pranishëm në Qendrën e Testimit, një orë para fillimit të testimit;
- Kenë me vete letërnjoftimin;
- Hyjnë brenda në kohën e caktuar, pas apelit të personit të autorizuar;
- Ulen sipas udhëzimeve të administruesit / personit të autorizuar;
- Kenë me vete një laps (grafit HB).
- Kenë me vete një shishe me ujë të pijes;
- Plotësojnë me kujdes të gjitha të dhënat në Fletëpërgjigje;

NUK u lejohet të :

- Vonohen në provim
- **Kenë telefon celular apo ndonjë mjet tjetër për komunikim gjatë testimit;**
- Ndërrojnë vendin pa lejen e administruesit.
- **Kopjojnë në asnjë lloj forme;**
- Pëshpërit apo të komunikojnë me të tjerët, në asnjë lloj forme;
- Dëmtojnë Fletëpërgjigjen, apo broshurën e testit;
- Pengojnë të tjerët gjatë kohës së testimit.

Maturantët që nuk u përmbahen këtyre rregullave, do të largohen nga Provimi i Maturës.

FJALA E MINISTRIT



Të nderuar maturantë, së shpejti do t'i nënshtroheni Provimit të Maturës Shtetërore, ku do tregoni aftësitë dhe shkathtësitë tuaja, të cilat i keni përvetësuar gjatë dymbëdhjetë viteve të shkollimit, e me rezultatet e arritura do të pajiseni me **CERTIFIKATË**, dokument ky që do të jetë kusht për pranim në studime në institucionet e arsimit të lartë.

Provimi i Maturës Shtetërore është një dëshmi se, Ju jeni të gatshëm që të përballeni me sfidat e jetës dhe jeni të përgatitur për të vazhduar studimet e mëtejme në arsimin e lartë.

Jeni para një sprove dhe para një momenti të rëndësishëm, nga se, rezultatet tuaja të gjertanishme në shkollë dhe rezultatet që do ti tregoni në provimin e maturës, do t'ju bëjnë të mundur që të vazhdoni arsimin e lartë atje ku Ju dëshironi dhe e meritoni.

Provimi i Maturës Shtetërore është një instrument matës për të gjithë maturantët e Kosovës.

Ne do t'ju krijojmë kushte që Ju të tregoni dijen që posedoni dhe ta kaloni këtë provim me sukses. Në këto situata, pranë jush do të jenë mesimdhënësit, prindërit, DKA-të, MASHT-i dhe shoqëria në përgjithësi. Rezultatet e mira do t'ju bëjnë që të ndiheni mirë dhe krenarë gjatë gjithë jetës.

Republika e Kosovës synon të shndërrohet në një shoqëri të dijes, një shoqëri me aftësi dhe shkathtësi të shekullit 21.

Në emrin tim personal dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe MASHT-it, ju uroj që të arritni rezultate sa më të larta.

Suksese!

Shyqiri Bytyqi

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

PROCEDURAT E PROVIMIT

1. Provimi i Maturës organizohet më: **28 – 31 maj 2018 dhe 05 - 08 qershor 2018;**
2. Paraqitja e Provimit të Maturës bëhet më: **14 maj – 24 maj 2018;**
3. Provimi mbahet në Qendrat e Testimit, të cilat i cakton DKA/MASHT;
4. Procesi i testimit fillon në orën 10:00 dhe përfundon në orën 13:00, ku (15-20) minuta në fillim jepen udhëzime për testim.
5. Maturantët duhet të jenë në orën 9:00 te Qendrat e Testimit;
6. Veprohet sipas udhëzimeve të administruesit të Testit;
7. Plotësoni me kujdes Broshurën e Testit e, sidomos Fletëpërgjigjen;

KRITERET E PROVIMIT TË MATURËS

1. Provimi i Maturës Shtetërore organizohet në dy ditë. Në ditën e parë nxënësit do t'i nënshtrohen provimit nga lëndët e përgjithshme, ndërsa në të dytën, nga lëndët profesionale, sipas profileve përkatëse;

2. Të gjithë nxënësit/kandidatët e gjimnazeve të cilët me sukses e kanë përfunduar vitin e fundit pajisen me **DIPLOMË** dhe kanë të drejtë të nënshtrohen provimit të maturës shtetërore.

3. Të gjithë nxënësit/kandidatët që kanë kryer me sukses provimin përfundimtar të arsimit profesional pajisen me **DIPLOMË të profesionit**.

4. Pragu i **kalueshmërisë** në provimin e maturës shtetërore **është 40%** nga rezultati i përgjithshëm i testit (duke përfshirë atë të ditës së parë dhe të dytë);

5. Maturantët që nuk mund ta arrijnë kriterin e kalimit, 40% në këtë afat, do të kenë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të maturës në afatet vijuese;

6. Kandidatët që kanë kaluar (40% e më shumë) provimin e maturës shtetërore pajisen me **CERTIFIKATË** të maturës dhe fiton të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs për studime Universitare;

7. Për pranim në Universitet - Njësitë Akademike përcaktojnë kriteret e pranimit.

(Sqarimet më të hollësishme maturantët do të marrin me rastin e shpalljes së konkursit për regjistrim në Universitet).

MODELI I TESTIT

• Testi përmban kërkesa (pyetje) të tipit të mbyllur, me zgjidhje të shumëfishta, me katër alternativa, nga të cilat vetëm njëra është e saktë.

• Testi organizohet për dy (2) ditë:

Dita e parë:

• Testi përmban 100 kërkesa (pyetje) nga lëndët e përgjithshme, Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Matematikë.

1. Gjuhë amtare----- 50 kërkesa

2. Gjuhë angleze----- 30 kërkesa

3. Matematikë----- 20 kërkesa

Dita e dytë:

• Testi përmban 100 kërkesa (pyetje) nga lëndët e profilit përkatës arsimor.

I. Gjimnazi Matematikë – Informatikë

Dita e dytë: 100 kërkesa

1. Matematikë----- 30 kërkesa

2. Fizikë----- 15 kërkesa

3. Kimi----- 15 kërkesa

4. Biologji----- 15 kërkesa

5. Informatikë----- 25 kërkesa

II. Gjimnazi i Shkencave natyrore

Dita e dytë: 100 kërkesa

1. Matematikë----- 20 kërkesa

2. Fizikë----- 20 kërkesa

3. Kimi----- 20 kërkesa

4. Biologji----- 20 kërkesa

5. Informatikë----- 20 kërkesa

III. Gjumnazi i Shkencave shoqërore

Dita e dytë: 100 kërkesa

- | | |
|----------------------|------------|
| 1. Histori ----- | 20 kërkesa |
| 2. Gjeografi ----- | 20 kërkesa |
| 3. Sociologji ----- | 20 kërkesa |
| 4. Psikologji ----- | 20 kërkesa |
| 5. Informatikë ----- | 20 kërkesa |

IV. Gjumnazi Gjuhësor

Dita e dytë: 100 kërkesa

- | | |
|------------------------------|--|
| 1. Gjuhë shqipe ----- | 20 kërkesa |
| 2. Gjuhë e dytë e huaj ----- | 20 kërkesa (Gjuhë gjermane ose frënge) |
| 3. Histori ----- | 20 kërkesa |
| 4. Gjuhë angleze ----- | 20 kërkesa |
| 5. Informatikë ----- | 20 kërkesa |

V. Gjumnazi i Përgjithshëm

Dita e dytë: 100 kërkesa

- | | |
|----------------------|------------|
| 1. Kimi ----- | 20 kërkesa |
| 2. Biologji ----- | 20 kërkesa |
| 3. Histori ----- | 20 kërkesa |
| 4. Gjeografi ----- | 20 kërkesa |
| 5. Informatikë ----- | 20 kërkesa |

VI. Arsimi Profesional I.

(Shëndetësi, Bujqësi, Hortikulturë, Teknologji ushqimore, Kimi – teknologji, Gjeologji)

Dita e dytë: 100 kërkesa

- | | |
|---------------------------------|------------|
| 1. Kimi ----- | 25 kërkesa |
| 2. Biologji ----- | 25 kërkesa |
| 3. Informatikë ----- | 25 kërkesa |
| 4. Ekonomi me ndërmarrësi ----- | 25 kërkesa |

VII. Arsimi Profesional II.

(Elektroteknikë, TIK, Komunikacion, Ndërtimtari, Arkitekturë, Gjeodezi, Tekstil, Xehetari)

- | | |
|---------------------------------|------------|
| 1. Matematikë ----- | 30 kërkesa |
| 2. Fizikë ----- | 15 kërkesa |
| 3. Informatikë ----- | 30 kërkesa |
| 4. Ekonomi me ndërmarrësi ----- | 25 kërkesa |

VIII. Arsimi Profesional III.

(Administratë, Ekonomi, Hoteleri, Turizëm, Shërbimi Postë – Telefoni)

- | | |
|----------------------------------|------------|
| 1. Ed. qytetare ----- | 30 kërkesa |
| 2. Informatikë ----- | 20 kërkesa |
| 3. Ekonomi dhe ndërmarrësi ----- | 30 kërkesa |
| 4. Gjeografi ----- | 20 kërkesa |

XI. Arsimi Profesional IV. (Muzikë)

- | | |
|------------------------------------|------------|
| 1. Teori e muzikës dhe harmoni --- | 40 kërkesa |
| 2. Njohje instrumentesh ----- | 20 kërkesa |
| 3. Histori e muzikës ----- | 20 kërkesa |
| 4. Forma muzikore ----- | 10 kërkesa |
| 5. Informatikë ----- | 10 kërkesa |

X. Arsimi Profesional V. (Art dhe Grafikë)

- | | |
|---------------------------------|------------|
| 1. Histori e artit ----- | 35 kërkesa |
| 2. Teori e formës ----- | 30 kërkesa |
| 3. Ekonomi me ndërmarrësi ----- | 15 kërkesa |
| 4. Informatikë ----- | 20 kërkesa |